



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Njësia për drejta e njeriut dhe barazi gjinore (NJDNJBGJ)
Periudha raportuese	Prill 2016
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Premtime Preniqi

1.PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues

Njësia për drejtat e njeriut dhe barazi gjinore (NJDNJBGJ) është mekanizëm për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, standardet ndërkombëtarë , politikat, strategjitë dhe planet e veprimeve të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Ecuria e punës së NJDNJBGJ është: Trajtimi i barabartë gjinor sipas Ligjit për barazi gjinore, mundësi të barabarta sipas Ligjit kundër diskriminimit, masat afirmative mbi barazinë e mundësive për personat me aftësi të kufizuar, kundër dhunës në familje. Mbrojtja e të dhënave personale sipas Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale etj.

Njësia për drejtat e njeriut dhe barazi gjinore (NJDNJ-BGJ) nuk ka kod buxhetor dhe aktivitetet i organizon duke bashkëpunuar me drejtori brenda Komunës dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe lokale.

2.AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me plan programin e Komunës për drejtorinë tuaj .

- Grupi punues "SoRI", në bashkëpunim me GIZ, do të organizojmë takimin e radhës;
- Planifikojmë të mbajmë disa aktivitete vetëdijesuese në shkolla dhe presim nga OSBE të na mbështesë me buxhet;
- Takimi i rregullt i Këshillit komunal koordinues për viktimat e dhunës;

- Në bashkëpunim me organizatën USAID, është themeluar Komitetit këshillëdhënës për të drejtat pronësore të grave, në përbërje të 7 zyrtarëve komunalë për barazi gjinore nga komunat e Kosovës, do të mbahet aktiviteti i radhës, me qëllim të planifikimit të agjendës dhe datave të organizimit të trajnimit në temën “Aftësitë menaxhuese”.

AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtorja juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë

1. Në bashkëpunim me organizatën “Deutsche Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit (GIZ)”, kemi mbajtur takimin e përbashkët të Grupit punues “SoRI”. Qëllimi i përgjithshëm i këtij takimi ishte që të bashkohen të gjithë anëtarët e komunave të Kosovës partnere me GIZ-në dhe të shqyrtohen :

-Të drejtat e njeriut;

-Të drejtat sociale;

-Sfidat në zbatimin e të drejtave sociale;

1.1 Kemi mbajtur takimin e radhës së Grupit punues për “Projektin Rajonal për të Drejtat Sociale të grupeve vulnerabël” (SoRI). Në këtë takim kanë marr pjesë edhe përfaqësuesit nga “**Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH**”. Gjatë takimit u shqyrtua planin i grupit dhe misioni dhe vizioni i OJQ-ve lokale, të cilat do të jenë pjesë ndihmëse e grupit në realizimin e këtij plani.

1.2. Përcaktimi i kriterëve për thirrje për aplikim me projekte të OJQ-ve në financim të aktiviteteve ndërlidhur me promovimin dhe avancimin e të drejtave sociale.

Termet e referencës për përzgjedhjen e OJQ-ve për implementimin e aktiviteteve të parapara sipas planit të veprimit të Grupit punues -Projekti “Të drejtat sociale për grupet vulnerabël /të marginalizuara - SoRI”

Grupi i parë: Identifikimi i fëmijëve në situatë rruge dhe puna e fëmijëve;

Grupi i dytë: Sigurimi i qasjes për personat me aftësi të kufizuara.

2. Në bashkëpunim me OSBE-në, kemi harmonizuar Udhërrëfyesin për Avokim, për të nxitur me tej barazinë gjinore, fuqizimin e grave dhe forcimin e kapaciteteve të komunave për të rritur pjesëmarrjen e grave në politikë dhe procese vendimmarrëse.

3. Në bashkëpunim me organizatën USAID, është themeluar komitetit këshillëdhënës për të drejtat pronësore të grave, në përbërje të 7 zyrtarëve komunalë për barazi gjinore nga komunat e Kosovës, kemi mbajtur takimin e përbashkët me qëllim të planifikimit të agjendës dhe datave të organizimit të trajnimit në temën “Aftësitë menaxhuese”, trajnim ky që do të organizohet dhe financohet

nga Programi i USAID-it për të drejtat pronësore, ku do të përfshihen edhe zyrtarët komunalë për barazi gjinore në Kosovë, të cilët nuk janë pjesë e Komitetit këshillëdhënës.

4- Grupi i grave në mbledhjen e fundit ka shqyrtuar planin e aktiviteteve të radhës, si dhe ka mbajtur takimin me OJQ-të lokale për të bashkëpunuar për realizimin e aktiviteti të 12 Majit, tashmë viti i tretë, ku organizohet fushata me moton “Dhuro gjak, shpëto jetë”.

4.1. Në bashkëpunim me Grupin e Grave, në kuadër të vizitave sipas planit të punës, kemi vizitua Kishën Katolike, ku jemi pritur nga motra Smila, e cila na ka njoftuar me aktivitete që mbahen në kuadër të Kishës (ligjërata në aspektin social) dhe ndihma që i ofrohet familjeve të varfra, si dhe me konviktin e studentëve, i cili objekt është në kuadër të kishës, ku qëndrojnë 80 vajza nga Kosova, të cilat nuk e kanë gjendjen e mirë ekonomike, pa dallim feje.

4.2 Është mbajtur takimi i përbashkët me Grupin e Grave dhe OJQ “ Women for Women”, ku kemi shkëmbyer planet e punës për bashkëpunim në të ardhmen.

5. Këshilli komunal kundër dhunës ka mbajtur takimin e radhës, ku kemi shqyrtuar rastet e dhunës në familje, trafikimin dhe ngacmimet seksuale, ku pjesëmarrës ishin: QPS, Policia e Kosovës, mbrojtësit e viktimave, Strehimorja, CLARD - ndihme juridike falas etj.

4. *AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.*

Aktivitet e poshtëshënuara janë aktivitete që janë në proces gjatë tërë vitit nga grupet punese.

1- Këshillit komunal kundër dhunës, është trup bashkëveprues në mes të të gjithë akterëve që merren me parandalimin, ofrim të shërbimeve, mbrojtje të të drejtave dhe avokim për viktimat e dhunës. Si koordinatorë e grupit, i ftoj në mbledhje të rregullt çdo 3 muaj dhe, sipas nevojës edhe me shpesh.

Qëllimi i Këshillit është:

- Raportimi i të dhënave për rastet e dhunës tek koordinatori;
- Krijimi i një data-baze me të gjitha të dhënat mbi viktimat, të ndara në bazë të llojit të dhunës së përjetuar¹, seksit, moshës, statusit, komunës, institucionit nga i cili është ofruar shërbimi etj.;
- Shkëmbimi i përvojave në lidhje me ndihmën e drejtpërdrejtë;
- Fuqizimi i bashkëpunimit në mes partnerëve të ndihmës së drejtpërdrejtë;
- Avokim për shërbime të qëndrueshme ndaj viktimave tek autoritet komunale, bizneset, organizatat jo qeveritare dhe subjekteve të tjera;
- Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të viktimave.

¹Viktima ka përjetuar dhunë në familje, është viktimë e trafikimit me qenie njerëzore, ka përjetuar dhunë seksuale, ngacmim seksual apo është rast viktimë e incestit.

2. Në bashkëpunim me organizatën “Deutsche Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit (GIZ)” pas nënshkrimit të marrëveshjes së mirëkuptimit me GIZ, kemi themeluar grupin punues me vendim të Kryetarit, ku deri në shtator 2017, do të kemi aktivitete të ndryshme sa i përket përmirësimit të kushteve për sigurimin e të drejtave të barabarta sociale për grupet në nevojë.

3. Grupi i Grave është në organizmi të aktiviteti të radhës, ku është viti i tretë i fushatës, i cili mbahet me 12 maj, me moto “Dhuro gjak, shpëto jetë”.

4. Në bashkëpunim me organizatën USAID, është themeluar Komitetit këshillëdhënës për të drejtat pronësore të grave, në përbërje të 7 zyrtarëve komunalë për barazi gjinore nga komunat e Kosovës, dhe gjatë viti do vazhdojmë edhe me mënyra të tjera afirmative që ta sensibilizojmë opinionin për rëndësinë e kësaj çështjeje .

i. Buxhetin e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese

-Njësia për drejtat e njeriut dhe barazi gjinore nuk ka kode buxhetore.

4.1.3 Takimet me palë

Kam takime të ndryshme me palë, ku varësisht nga natyra edhe i qasem, duke filluar nga natyra e dhunës në familje, shkeljes së të drejtave të njeriut dhe për mbrojtjen e privatësisë .

5. Takimet me institucione të tjera

ABGJ, MAPL, ASHMDHP, OSBE, KFOR-i italian, Save the Children , GIZ, USAID, UNDIP, CLARD etj.

6. Diskutime Publike/Takimet me qytetarë

6.1.1 Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

i. Lëndët e pranuarra, kryera dhe në përfundim e sipër.

7. Takime të tjera

Mbledhjet e organizuara brenda komunës, anëtare e Grupit për siguri në bashkësi, është mbajtur takimi në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Komunën e Prishtinës dhe partnerët tjerë, tryezë e rrumbullakët “Ndërtimi i urave”. Agjencia për Barazi Gjinore, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Tryeza e përbashkët me Grupin e Grave deputete të Kuvendit të Kosovës, Debatin Publik lidhur me draft-raportin e hulumtimit mbi “Mbrotjtjen ligjore kundër diskriminimit në Republikën e Kosovës”, si pjesë e projektit rajonal që përfshinë Evropën Juglindore. Punëtorja e organizuar nga ASHMDHP, me temën “Mbrotjtja e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë”. Punëtorja nga Misioni i TAIEK, ekspert për zbatimin e Paketës ligjore të drejtave të njeriut në nivel lokal, për të diskutuar mbi sfidat me të cilat përballen shtetet anëtare të BE-së në zbatimin e legjislacionit të të drejtave të njeriut, me theks të veçantë në kërkesat e nivelit lokal kundrejt nivelit qendror.

8. *SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.*

- Mungesa e kodit buxhetore për implementimin e projekteve.

9. *REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë, etj.*

10. *AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES - Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues*

- Organizimi i aktivitet në bashkëpunim me Grupin e grave, i cili mbahet për të tretin vit me radhë, me moton “Dhuro gjak, shpëto jetë”.
- Puna e grupit në bashkëpunim me GIZ, shqyrtimi i dokumentacioneve të OJQ -ve lokale të cilat do të aplikojnë për grante.

11. *TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme*